



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 25, datë 07.10.2021

MBI

“MIRATIMIN E RREGULLORES TË MBROJTJES NGA ZGJARRI DHE SHPËTIMI, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjit nr. 80/2015, për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve”, pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores të mbrojtjes nga zgjarri dhe shpëtimi në UART, përcjellë nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Rektorit me nr. 154, datë 17.09.2021, me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores të funksionimit të Sekretarive Mësimore të Fakulteteve, në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI


Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE



RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE

SHPËTIMI NË

UNIVERSITETIN E ARTEVE

Bazuar në Ligjin për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri

dhe Shpëtimin, Nr.152/2015



Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 25 datë 07/10/2021



PËRMBAJTJA

KAPITULLI	Faqe
I Dispozita të përgjithshme	3
II Masat e mbrojtjes nga zjarri	4
III Detyrat e UART	6
IV Sistemet, pajisjet dhe instalimet e shuarjes së zjarrit	8
V Procedura dhe veprimet në rast zjarri	9
VI Dispozitat kaluese dhe përfundimtare	10





RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Misioni

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në vijim shërbimi i MZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Kjo strukturë vepron Bazuar në Ligjin për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Nr.152/2015 dhe “Rregullores Për Mbrojtjen nga Zjarri” të UART. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri dhe ndërhyrja për shuarjen e zjarreve të shkaktuara aksidentalisht ose nga dora e njeriut.

KAPITULLI I.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet misioni, organizimi, detyrat, mënyra e zbatimit të masave të parandalimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e inspektorit dhe punonjësve të tjerë për zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përgjegjësitë për shkak të moszbatimit të masave të përcaktuara nga kjo Rregullore dhe legjislacioni në fuqi, detyrat e personelit në rastet e shfaqjes së zjarrit, si dhe masave tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe pasurisë në UART.

Neni 2

Dispozitat e kësaj Rregullore vlejnë për personelin akademik, ndihmës akademik, administrativ, me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe të gjithë personave të cilët mund të ndodhën në hapësirat e UART.

Neni 3

Rregullorja përcakton:

1. Masat për inspektimin dhe veprimet për parandalimin apo zvogëlimin e rrezikut nga shpërthimi i zjarrit, si dhe për ofrimin e ndihmës, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve dhe pasurisë në UART.
2. Mënyrën e organizimit dhe kryerjes së kontrollit të brendshëm në zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin sipas legjislacionit në fuqi, kësaj Rregulloreje si dhe detyrave të personelit të cilët kryejnë kontrollin.
3. Mënyrën e aftësisimit dhe mënyrën e përdorimit të pajisjeve, mjeteve dhe instalimeve për fikjen zjarrit.





4. Personelin përgjegjës për mirëmbajtje në gatishmëri të pajisjeve, mjeteve dhe instalimeve për fikjen zjarrit.
5. Detyrat e personelit të caktuar dhe përgjegjës, në kuptimin e zbatimit të masave sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.
6. Përgjegjësitë për zbatimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe përgjegjësitë për shkak të moszbatimit të masave të mbrojtjes nga zjarri të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
7. Detyrat e personelit në rast zjarri.
8. Masat e tjera për mbrojtje nga zjarri.

Neni 4

Pjesë përbërëse të kësaj Rregulloreje janë:

1. Vendimi i shërbimit të MZSH për renditjen e UART në kategorinë e rrezikshmërisë nga zjarri.
2. Plani i aftësisë të personelit.
3. Plani i shenjzimit të rrugëve të evakuimit dhe shpëtimin në rast zjarri.
4. Përshkrimi dhe renditja e pajisjeve, mjeteve dhe instalimeve zjarrfikëse.
5. Dokumentacioni mbi kontrollin periodik dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, mjeteve dhe instalimeve të mbrojtjes nga zjarri.(procesverbal)
6. Rregullore të tjera nga fusha e mbrojtjes nga zjarri.

KAPITULLI II.

MASAT E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Neni 5

Inspektori i MZSH në UART, është përgjegjës për inspektimin dhe mirëmbajtjen në gjendje të rregullt të pajisjeve elektrike, instalimeve si dhe të çdo lloj aparature, të cilat mund të shkaktojnë shfaqjen dhe zgjerimin e zjarrit, në zbatim me normat teknike dhe legjislacionin në fuqi. Mirëmbajtja duhet të kryhet nga personeli i autorizuar i UART sipas kërkesës së Inspektorit.

Neni 6

Çdo anëtar i personelit të UART është i detyruar të zbatojë masat e mbrojtjes nga zjarri në vendin e punës sipas legjislacionit në fuqi, kësaj Rregulloreje dhe udhëzimeve të personave mbikëqyrës. Ndalohet kryerja e veprimeve/punimeve që mund të jenë nxitës të zjarrit, e përdorimit të mjeteve piroteknike për qëllime artistike. Leja për këto aktivitete si dhe përdorimi i tyre jepet nga administratori pas njoftimit me shkrim nga ana e inspektorit të MZSH të UART, pasi të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtje nga zjarri.





Neni 7

Personat juridik të cilët kryejnë punime apo veprime të caktuara në hapësirat e UART, janë të detyruar që ti përmbahen dhe të zbatojnë masat e mbrojtjes nga zjarri konform legjislacionit në fuqi dhe kësaj Rregulloreje. Ata janë të detyruar të emërojnë një person të përhershëm, përgjegjës për inspektimin dhe marrjen e masave për MZSH.

Neni 8

Të gjitha aparaturat, pajisjet, mjetet dhe instalimet, të cilat gjatë përdorimit mund të shkaktojnë zjarr, duhet të jenë kontrolluar/inspektuar dhe në rast keqfunksionimi duhen ndërruar/zëvendësuar.

Neni 9

Inspektimi/kontrolli kryhet nga Inspektori i UART, i cili mban procesverbalin e nevojshëm mbi konstatimet dhe merr masat e duhura sipas kësaj Rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Hapësirat apo ambientet për depozitimin e karburanteve për kaldaja, gjeneratorë, gazrave si dhe artikujve tjerë që mund të shkaktojnë zjarr apo digjen lehtësisht, duhet të jenë të ajrosura mirë dhe në to duhet të jetë e dallueshme qartë shenja e rrezikut të zjarrit.

Neni 11

Konsumimi i duhanit në hapësirat e UART dhe në vendet që paraqesin rrezik të lartë të rënies së zjarrit, është rreptësisht i ndaluar.

Neni 12

Aparaturat, pajisjet, impiantet elektrike të skenës, me përfundimin e punës, detyrimisht duhet të çkyçen të gjitha. Parregullsitë e vërejtura, përkatësisht, prishjet apo defektet e menjëhershme, duhen raportuar tek Inspektori i MZSH të UART.

Neni 13

Rrugët, daljet dhe shkallët e përcaktuara për evakuim, duhet të kenë shenjat dalluese përkatëse sipas legjislacionit dhe duhet të jenë gjithnjë të lira për kalim. Për këtë, përgjegjës është Inspektori i MZSH në UART.

Neni 14

Të gjitha pajisjet, mjetet, instalimet dhe sistemet që përdoren për fikjen e zjarrit, sipas destinacionit dhe përdorimit të tyre në momentin e caktuar duhet:

1. Të kenë të shënuara shenjat përkatëse qartësisht të dallueshme.





2. Të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme.
3. Të jenë funksionale dhe ti jenë nënshtruar kontrolleve periodike për mirëfunksionimin e tyre, shoqëruar kjo, me etiketat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI III DETYRAT E UART

Neni 15

UART ka për detyrë:

1. Të marrë masa për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.
2. Të caktojë personel teknik në organikën dhe strukturën e tij, të specializuar me detyra në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
3. Të bashkëpunojë me shërbimin e MZSH-së.
4. Të planifikojë fonde financiare për ndërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
5. Të nxjerrë rregullore të ndryshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, sipas fushës që mbulon.
6. Të pajisi strukturat e tij me pajisje, mjete, instalimet dhe sisteme sinjalizimi automatike, për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në përputhje me normat teknike, si dhe t'i mbajnë ato në gatishmëri.
7. Të koordinojë me shërbimin vendor të MZSH-së për marrjen e masave parandaluese të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
8. Administratori apo personi i autorizuar nga ai, është përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe aplikimin e të gjithave masave të mbrojtjes nga zjarri.

Neni 16

Të drejtat dhe detyrat e inspektorit

Punonjësi i inspektimit të MZSH-së, në UART, gjatë kryerjes së inspektimit, përveç të drejtave dhe detyrimeve të caktuara në ligjin "Për inspektimin", ka edhe këto të drejta e detyra:

1. Të kontrollojë masat e mara dhe pajisjet, mjetet dhe instalimet e mbrojtjes nga zjarri në çdo objekt/ambient ku aktiviteti që kryhet paraqet rrezikshmëri për rënien e zjarrit.
2. Të inspektojë çdo lloj objekti/ambienti, instalime të ndryshme, magazina për mbajtjen e mallrave, materialet dhe dokumentacionin përkatës që ka të bëjë me sigurinë nga zjarri, detyrimet e personelit për zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, duke zbatuar programin e miratuar të ushtrimit të kontrollit.





3. Në rast të rënies së zjarrit, të bashkëpunojë me shërbimet e MZSH dhe Policinë e Shtetit, për përcaktimin e shkaqeve të zjarreve.
4. Të përcaktojë afatin për eliminimin e mangësive apo parregullsive në zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
5. Të mbajë për çdo objekt/ambient të kontrolluar dokumentacionin përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

Neni 17

Detyrat e shërbimit të MZSH në UART

Shërbimi i MZSH-së në UART, ka këto detyra kryesore:

1. Ndërhyn me të gjitha mjetet, pajisjet dhe forcat që disponon, për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme.
2. Harton raportin e ndërhyrjes me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri.
3. Organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve dhe të pronës nga rreziku i zjarrit.
4. Organizon punën për rritjen e gatishmërisë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit dhe ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme.
5. Organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me personelin, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri.
6. Ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe në përpilimin e aktit të ekspertizës teknike.
7. Bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera.
8. Përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së.
9. Kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese.
10. Njofton rregullisht personelin për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit.

Neni 18

Të drejtat e shërbimit të MZSH në UART

Shërbimi i MZSH-së në UART ka këto të drejta:





1. Bllokon, deri në plotësimin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, veprimtaritë dhe kategoritë e proceseve mësimore dhe aktiviteteve artistike në të gjitha mjediset e UART, kur ato paraqesin rrezik për jetën e njerëzve ose pronën dhe kur në to nuk janë zbatuar dispozitat e parashikuara në këtë Rregullore dhe legjislacionit në fuqi.
2. Bllokon të gjitha mjediset ku ka rënë zjarr, për të ruajtur të paprekur vendin e ngjarjes.
3. Urdhëron largimin e menjëhershëm nga mjediset e UART të pajisjeve, materialeve e lëndëve të rrezikshme, që sjellin pasoja për jetën e njerëzve dhe të pronës.
4. Merr masa administrative ndaj kundërvajtësve, sipas dispozitave të veçanta të këtij ligji dhe në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 19

Personat fizikë dhe juridikë, që veprojnë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe të kësaj Rregulloreje, kur veprimet apo mosveprimet e tyre përkatëse nuk përbëjnë veprë penale, janë përgjegjës për kundërvajtje administrative.

KAPITULLI IV

SISTEMET, PAJISJET DHE INSTALIMET E SHUARJES SË ZJARRIT

Neni 20

1. Pajisja me sisteme, mjete dhe instalime për shuarjen dhe mbrojtjen nga zjarri, si dhe instalimet e tyre, bëhen në zbatim të rregullave e standardeve të sigurisë nga zjarri dhe legjislacionit në fuqi.
2. Sistemet, pajisjet, mjetet dhe instalimet për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin, shoqërohen me certifikatën e origjinës.
3. Mirëmbajtja e mjeteve, sistemeve, pajisjeve dhe instalimeve për sigurinë nga zjarri dhe shpëtimin kryhet në përputhje me rregullat dhe standardet ndërkombëtare për sigurinë nga zjarri.
4. Inspektori i shërbimit të MZSH-së në UART, kryen kontrollin e mjeteve dhe pajisjeve, sistemeve manuale e automatike të sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin. Inspektori i shërbimit të MZSH-së, në UART, kur konstaton shkelje të këtij neni, merr masat e duhura në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe të kësaj Rregulloreje.
5. Të gjitha objektet e UART duhet të kenë instalime të rregullta të rrufepritësit dhe tokëzimeve prekëse. Rregullsia e instalimit, kontrolli/inspektimi si dhe matjet e rezistencës të këtyre instalimeve, bëhet çdo vit.



KAPITULLI V
PROCEDURAT DHE VEPRIMET NË RAST ZJARRI

Neni 21

1. Çdo anëtar i personelit, qytetar ose të pranishëm në UART, të cilët vërejnë rrezik të menjëhershëm për shpërthimin e zjarrit dhe apo zjarrin, duhet të veprojë, kontribuojë, të marri pjesë dhe të ndihmojë pa frikë për shuarjen e zjarrin në qoftë se ky veprim, nuk paraqet rrezik për veten dhe të tjerët.
2. Nëse personeli, qytetari ose shërbimi i rojës të natës i pranishëm, nuk mund të veprojnë sipas paragrafit të mësipërm të këtij neni, ai njofton menjëherë shërbimin e MZSH, inspektorin e MZSH të UART dhe organet kompetente në numrin e caktuar të telefonit i cili duhet të jetë i dukshëm dhe i lexueshëm në të gjitha ambientet e UART.
3. Personeli përgjegjës për mbrojtjen nga zjarri, në rast të rrezikut apo rënies së zjarrit, përcakton se cilat masa duhen marrë në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve për fikjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin duke kërkuar persona të lënduar apo të bllokuar si dhe merr përsipër udhëheqjen e veprimeve për fikjen e zjarrit deri në ardhjen e shërbimit të MZSH.
4. Mënyra e evakuimit do të bëhet sipas planit të evakuimit emergjent i cili në periudha të caktuara kohore, duhet të testohet.

Neni 22

Para lëshimit të hapësirës ku ka ndodhur zjarri dhe fillimin e fikjes së zjarrit, personeli i MZSH në UART duhet:

1. Të ndërpresë rrymën elektrike.
2. Të njoftojë shërbimin e MZSH.
3. Të nxjerrë në vend të sigurt nëse kjo është e mundur, bombolat me gaz apo pajisje me lëngje ndezëse nëse ka të tilla.
4. Të nxjerrë në vend të sigurt pajisjet e rëndësishme ose dokumentacionin arkivor kur kjo është e mundur.
5. Të parandalojë krijimin e panikut dhe të ndihmojë në evakuimin e personelit jashtë hapësirës ku ka rënë zjarri.

Neni 23

Pas përfundimit të aksionit të fikjes së zjarrit, personeli i ngarkuar, duhet të kontrollojë sistemet, pajisjet, mjetet dhe instalimet e përdorura gjatë shuarjes së zjarrit dhe ti kthejë ato përsëri në vendet e caktuara në gjendje gatishmërie sipas standardeve të miratuara në legjisllacion.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KAPITULLI VI
DISPOZITAT KALUESE DHE PERFUNDIMTARE

Neni 24

Përmbajtja e kësaj Rregulloreje, duhet të njihet nga gjithë personeli akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe studentët në UART.

Neni 25

Kjo Rregullore, rifreskohet dhe plotësohet në mënyrë periodike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të Senatit Akademik

